

VENDIM
Nr. 82/2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
92/2017, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË
POSAÇËM TË APELIMIT,” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 23.12.2020

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË
APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri (2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT		(20)
LIGJOR		
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	11
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	9
IV. SEKRETAR I	I-a	1
PËRGJITHSHËM		
V. DREJTORIA E		(11)
MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE		
DHE MARRËDHËNIEVE ME		
MEDIAN DHE PUBLIKUN		

Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	3
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	1
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(9)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokoll/arkivi ****	IV-a	1
Magaznier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer/korrier	VI	1
Total		49

Shënim:

*Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT



